



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1042/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Dr.sc.Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Radojko Keciq, nga Komuna e Shtërpcës, për shkak të vendosjes së posterëve në objekte privat, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 13.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa lejuar ankesa e Radojko Keciq, nga Komuna e Shtërpcës, me shenjen ZL.Anr.1042/2017 e datës 13.11.2017, për shkak të vendosjes së posterëve në objekte private për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i me datën 13.11.2017 ka pranuar një ankes nga Radojko Keciq, nga Komuna e Shtërpcës, me të cilën ankesë theksohet se në shitoren e tij aktivistët nga radhët e subjektit politik SNS në mënyrë provokative kanë vendosur posterat duke e përdorur një ngjitës të fortë, me të cilat veprime e kanë dëmtuar fizikisht shitoren e tij. Më tutje ka theksuar se nga këto veprimem është dëmtuar shitroja pasi që siç thekson ai shpesh e ka kritikuar punën dhe veprimtarinë e tyre publikishtë dhe se për këto arsye tani edhe blerësit nuk hyjnë në shitore, pasi që ata mendojnë që po bashkëpunoj me subjektin politik të tyre.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të lejueshmërisë së ankesës gjeti se:

ankesa është e pa lejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve në ankes lidhur me shkeljen e pretenduar, sepse në kohën kur parashtruesi i ankesës e ka parashtrur ankesën lidhur me shkeljen e supozuar pra me datën 26.10.2017, fushata zgjedhore veç se ka përfunduar, ngase fushata zgjedhore ka filluar nga data 21.09.2017 deri me datë 21.10.2017. Prandaj, nga këto arsye arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZLAnr.1042/2017 me datën 13.11.2017.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa

Kryesuesi i Panelit
Dr.sc.Rafet Haxhaj